


FOL

RAPORT MBI MONITORIMIN E PUBLIKIMIT TË AKTGJYKIMEVE



Titulli: Raport mbi monitorimin e publikimit të aktgjykimeve (janar – dhjetor 2020)

Autore: Albana Hasani dhe Nora Bajrami

Viti i botimit: shkurt 2021

Publikuar nga: Lëvizja FOL

Andrea Gropa nr.35

Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

info@levizjafol.org

+386 (0)49 131 542

The logo for FOL (Lëvizja FOL) consists of the letters 'FOL' in a bold, red, sans-serif font. The letter 'O' is stylized with a small white dot in the center.

Të drejtat e autorit © 2021. Lëvizja FOL. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.

PËRMBAJTJA

Përmbledhja ekzekutive	1
Baza ligjore e publikimit të aktgjykimeve	4
Gjykata Supreme	5
Gjykata e Apelit	10
Gjykata Themelore e Prishtinës	14
Gjykata Themelore e Ferizajt	18
Gjykata Themelore e Mitrovicës	22
Gjykata Themelore e Prizrenit	26
Gjykata Themelore e Gjakovës	30
Gjykata Themelore e Pejës	34
Gjykata Themelore e Gjilanit	38
Rekomandime	43
Burimet	44

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Publikimi i aktgjykimeve, përveç që është në shërbim të realizimit të obligimeve që rrjedhin nga dispozitat ligjore përkatëse, ajo paraqet edhe një hap të rëndësishëm në respektimin e vlerave të gjyqësisë bashkëkohore. Rrjedhimisht, për t'u bërë pjesë e këtij misioni, nga janari i vitit 2019 gjykatat janë të obliguara që brenda 60 ditësh t'i publikojnë në ueb-faqet e tyre zyrtare të gjitha aktgjykimet, si akte që shënojnë epilogun e një procesi gjyqësor.

Transparenca në gjyqësorin e Kosovës paraqet një sfidë të vazhdueshme në aspektin e përmbushjes së misionit të ndërtimit të gjykatave të besueshme, si dhe një detyrë të pashmangshme të secilit gjyqtar dhe zyrtari tjetër që të ndihmoj në përmbushjen e këtij misioni. Padyshim se synimi i secilit prej tyre konsiston në drejtim të respektimit të parimeve dhe vlerave themelore të një gjyqësie bashkëkohore. Mirëpo monitorimi i punës së gjykatave, e sidomos i gjyqtarëve, paraqet një domosdoshmëri që siguron një mekanizëm të vlerësimit institucional dhe burim të gjetjes së mangësive që duhet të shmangen.

Raporti mbi Monitorimin e Publikimit të Aktgjykimeve janar-dhjetor 2020 përmban të dhëna që rrjedhin nga monitorimi i publikimit të aktgjykimeve në ueb-faqen e Këshillit Gjyqësor të Kosovës gjatë kësaj periudhe një vjeçare.

Ky raport ka për qëllim që të paraqes gjendjen faktike të publikimit të aktgjykimeve nga ana e gjykatave të Republikës së Kosovës, të identifikoj problemet dhe sfidat në publikimin e aktgjykimeve, si dhe të ofroj një listë rekomandimesh për veprimet që organet gjyqësore duhet të ndërmarrin për të përmirësuar shkallën dhe dinamikën e publikimit të aktgjykimeve.

Gjatë monitorimit kemi mbledhur të dhëna mbi numrin e aktgjykimeve të publikuara si dhe dinamikën e publikimit të tyre nga gjykatat. Që nga fillimi i monitorimit është vërejtur një rritje e vazhdueshme e publikimit të tyre nga shtatë gjykatat themelore (përfshirë degët e tyre), Gjykata e Apelit, si dhe Gjykata Supreme. Ndërkaq, në vijim do të përshkruajmë disa nga gjetjet kryesore të këtij monitorimi.

- Gjatë periudhës janar-dhjetor 2020 në ueb-faqen zyrtare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës janë publikuar gjithsej 18,755 aktgjykime. Ky nivel i publikimit është rritur 63 %, në krahasim me vitin paraprak (2019), kur në ueb-faqen e KGJK-së ishin publikuar 11,498 aktgjykime. Duhet të theksohet se në këto shifra nuk janë përfshirë aktgjykimet e njejta që janë evidentuar gjatë monitorimit dhe aktvendimet.
- Tri gjykatat me më së shumti aktgjykime të publikuara gjatë kësaj periudhe monitoruese janë: Gjykata Themelore e Prishtinës me 4,534 aktgjykime të publikuara; Gjykata Themelore e Prizrenit me 2,738 aktgjykime, si dhe Gjykata Themelore e Ferizajt me 1,937 aktgjykime.
- Degët e gjykatave me më së shumti aktgjykime të publikuara janë: Dhoma e Posaçme, si pjesë e Gjykatës Supreme, me 910 aktgjykime, Dega e Suharekës me 857 aktgjykime, si dhe Dega e Podujevës me 572 aktgjykime.
- Në këtë fazë gjithashtu është evidentuar se kanë filluar të publikojnë disa prej degëve gjyqësore, të cilat nuk kanë pasur asnjë aktgjykim të publikuar më herët (Dega e Vushtrrisë ka filluar të publikoj për herë të parë në muajin janar 2020, ndërsa Dega e Deçanit ka publikuar për herë të parë në muajin shkurt 2020).
- Gjyqtarët e Gjykatës Themelore të Prizrenit, prijnë me numrin e aktgjykimeve të publikuara gjatë kësaj periudhe. I pari në renditje qëndron gjyqtari Luan Berisha, i cili gjatë kësaj periudhe ka publikuar 497 aktgjykime. Më pas renditet gjyqtari Qemajl Suka, i cili ka publikuar 370 aktgjykime, si dhe gjyqtarja nga Gjykata Themelore e Ferizajt, Fitore Daci, me 368 aktgjykime të publikuara.
- Nga numri i përgjithshëm i aktgjykimeve të publikuara, 60 % janë aktgjykime të natyrës penale; 33 % janë aktgjykime të natyrës civile; 6 % janë administrative dhe vetëm 1 % janë të natyrës ekonomike.
- Shtatë gjykatat themelore kanë publikuar dukshëm më shumë aktgjykime të natyrës penale, ndërsa Gjykata Supreme dhe ajo e Apelit prijnë me publikimin e aktgjykimeve civile.
- Gjatë kësaj periudhe një vjeçare janë publikuar vetëm 79 aktgjykime të keqpërdorimit të pozitës dhe autoritetit zyrtar, 422 aktgjykime të dhunës me bazë gjinore dhe 72 aktgjykime të lëndëve të krimit të organizuar. Pra publikimi i aktgjykimeve të korrupsionit vazhdon të jetë ende i ulët, ndërsa në krahasim me vitin paraprak është dyfishuar publikimi i aktgjykimeve me bazë në dhunë gjinore dhe i aktgjykimeve të krimit të organizuar.

- Gjatë kësaj periudhe të monitorimit, zbatimi në përpikmëri i Vendimit të KGJK-së për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve është evidentuar në 15,459 aktgjykime, apo në 82 % të të gjitha aktgjykimeve të publikuara. Në pjesën tjetër prej 3,256 aktgjykimesh, përkatësisht në 18 % prej tyre, është vërejtur ngecje në zbatimin e këtij vendimi. Ndërkaq në periudhën janar-dhjetor 2019 vetëm 40% e të gjitha aktgjykimeve kanë qenë në përputhje me Vendimin e KGJK-së për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve.
- Gjatë kësaj periudhe, pjesa më e madhe e aktgjykimeve apo 17,658 prej tyre (94 %) janë publikuar në gjuhën shqipe, ndërsa 1,097 aktgjykime (6 %) janë publikuar në gjuhën serbe.
- Prej numrit të përgjithshëm të aktgjykimeve të publikuara, 353 aktgjykime (2%) janë të paanonimizuara, ndërsa në pjesën tjetër prej 18,462 aktgjykimesh (98 %) të dhënat personale janë anonimizuar në tërësi. Këto shifra tregojnë avancim të ndjeshëm krahasuar me periudhën janar-dhjetor 2019, ku 3.48 % të aktgjykimeve kanë qenë të paanonimizuara.
- Gjykatave iu janë dashur mesatarisht 105 ditë për ti publikuar aktgjykimet në ueb-faqen zyrtare të KGJK-së, llogaritur nga dita e shpalljes së tyre. Kjo mesatare bie ndesh me kohën e paraparë me Ligjin për Gjykatat, ku thuhet “gjykatat publikojnë të gjitha aktgjykimet në faqen e tyre zyrtare të internetit, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e nxjerrjes së aktgjykimit në pajtim me legjislacionin në fuqi”. Më së shumti kohë në publikimin e aktgjykimeve llogaritur nga dita e nxjerrjes i janë dashur Gjykatës Themelore të Prizrenit, të Gjakovës dhe asaj të Pejës, të cilat gjatë kësaj periudhe kanë publikuar edhe aktgjykime që janë shpallur para 3 vitesh. Ndërsa Gjykata Themelore e Ferizajt, Gjykata e Apelit dhe ajo e Prishtinës këtë afat e kanë respektuar në përpikmëri.

Në tabelën në vijim janë paraqitur të dhënat në lidhje me numrin e aktgjykimeve të publikuara në ueb-faqen zyrtare të KGJK-së gjatë periudhës janar-dhjetor 2020 nga të gjitha Gjykatat e Republikës së Kosovës.

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Gjykata Supreme	124	130	81	0	88	277	42	109	189	237	110	238
Gjykata e Apelit	154	220	120	43	62	242	202	150	113	149	139	138
Gjykata Themelore e Prishtinës	435	498	226	255	316	451	358	311	287	658	395	344
Gjykata Themelore e Ferizajt	244	224	203	105	39	63	152	204	112	189	196	206
Gjykata Themelore e Mitrovicës	271	143	70	0	0	51	230	77	203	516	107	242
Gjykata Themelore e Prizrenit	417	463	219	244	137	212	70	287	190	141	154	204
Gjykata Themelore e Gjakovës	281	176	79	8	86	115	177	102	138	200	216	164
Gjykata Themelore e Pejës	143	103	44	0	31	94	65	102	206	318	159	125
Gjykata Themelore e Gjilanit	104	134	117	43	43	125	95	98	92	95	41	160
Total:	2173	2091	1159	698	802	1630	1391	1440	1530	2503	1517	1821

Tabela 1. Aktgjykimet e publikuara nga të gjitha gjykatat e Republikës së Kosovës gjatë periudhës janar-dhjetor 2020.

METODOLOGJIA

Lëvizja FOL ka përdor metodën e monitorimit të vazhdueshëm sistematik, pra monitorimin ditor të ueb-faqes zyrtare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Të gjitha gjykatat janë informuar paraprakisht përmes postës elektronike se ato do të jenë subjekt i monitorimit për numrin dhe dinamikën e publikimit të aktgjykimeve, si dhe nëse publikimi i aktgjykimeve ndjek kërkesat e veçanta të ligjit, të udhëzimeve dhe të vendimeve tjera relevante. Të dhënat e mbledhura nga ky proces i monitorimit janë paraqitur për çdo muaj në formë infografikash dhe janë publikuar në rrjetet sociale të Lëvizjes FOL.

Nga aktgjykimet e publikuara, Lëvizja FOL ka krijuar një databazë me të dhëna. Rrjedhimisht, aktvendimet si dhe aktgjykimet e njejta të evidentuara gjatë kësaj periudhe nuk janë bashkangjitur në këtë databazë. Kjo databazë, ndër të tjera, përmban:

- numrin e përgjithshëm të aktgjykimeve të publikuara nga çdo gjykatë, për çdo muaj;
- nivelin e respektimit të protokolleve dhe afateve të përcaktuara për publikimin e vendimeve, si dhe pajtueshmëria e aktgjykimeve të publikuara me Ligjin për Gjykatat dhe udhëzimet administrative;
- mbrojtjen e të dhënave personale të palëve dhe specifikat tjera të cilat rregullohen me ligj dhe akte të tjera;
- gjyqtarët që kanë publikuar më së shumti aktgjykime;
- nivelin e zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve;
- gjuhën në të cilën janë publikuar aktgjykimet, si dhe
- llojin dhe natyrën e aktgjykimeve të publikuara.

BAZA LIGJORE E PUBLIKIMIT TË AKTGJYKIMEVE

Synimi drejt një sistemi gjyqësor transparent nuk interferon vetëm forcimin e sigurisë juridike në procesin e gjykimit, por ajo paraqet edhe boshtin kryesor të një demokracie bashkëkohore. Ashtu siç nocioni i transparencës është në shërbim të parimeve themelore të drejtësisë, në të njëjtën masë ajo pasqyron një barometër të nivelit të demokracisë në një shoqëri.

Parimi i gjykimit publik, pra gjykimit me dyer të hapura, është inkorporuar edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ku në nenin 31 të saj parashihet se gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata konsideron se në të mirë të drejtësisë është i domosdoshëm përjashtimi i publikut.

Për të përmbushur sa më mirë këtë mision, Ligji për Gjykatat (Nr. 06/L – 054) që u miratua në dhjetor të vitit 2018 dhe që është aktualisht në fuqi, ka bërë progres në rritjen e transparencës së gjyqësorit, duke e bërë të detyrueshme për të gjitha gjykatat publikimin e të gjitha aktgjykimeve brenda 60 ditësh në faqet e tyre të internetit. Kjo është paraparë në paragrafin 3 të nenit 6 të këtij ligji.

Për dallim nga dispozitat e ligjit aktual, Ligji për Gjykatat (Nr. 03/L-199) që paraprakisht ka qenë në fuqi i obligonte gjykatat të publikojnë aktgjykimet e plotfuqishme në faqet e tyre zyrtare të internetit, në afat kohor prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e arritjes së plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Kjo nënkupton se në raport me ligjin e mëparshëm, ligji aktual ka bërë progres duke e

zgjeruar gamën e vendimeve gjyqësore që duhet të publikohen. Pra, përveç aktgjykimeve të plotfuqishme, tashmë duhet të publikohen edhe ato vendime që nuk e kanë fituar ende plotfuqishmërinë ligjore.

Për mbrojtjen e të dhënave personale gjatë publikimit të aktgjykimeve, Këshilli Gjyqësor i Kosovës në fund të vitit 2019 ka nxjerrë Udhëzimin e ri Administrativ për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara dhe Manualin për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara . Ndryshe nga Udhëzimi Administrativ që paraprakisht ka qenë në fuqi, tashmë mbrojtësi i të akuzuarit (avokati) nuk i nënshtrohet përpunimit të të dhënave personale dhe se përjashtohet publikimi i aktgjykimeve penale ku përfshihen personat e mitur, kontestet martesore, vërtetimi apo kundërshtimi i atësisë etj.

Për çështjen e anonimizimit të aktgjykimeve, sipas këtij udhëzimi, përgjegjës është bashkëpunëtori profesional apo zyrtari ligjor në secilën gjykatë dhe degë të saj, i caktuar nga kryetari i gjykatës përkatëse. Aktgjykimet, sipas udhëzimit, duhet të publikohen në afat prej 60 ditësh nga data e nxjerrjes së aktgjykimit. Po ashtu nga ky udhëzim kërkohet që aktgjykimet të vendosen në ueb-faqe në formatin PDF.

Për të përmirësuar cilësinë e aktgjykimeve dhe për tu siguruar që ato ti përmbajnë elementet thelbësore, Këshilli Gjyqësor i Kosovës në vitin 2018 nxori Vendimin për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve dhe krijoi grupin punues për krijimin e Shabllonit për Standardizimin e Formave. Në këtë shabllon janë paraqitur format e të gjitha aktgjykimeve penale dhe civile dhe ndër të tjera kërkohet që në fillim të aktgjykimit të vendoset Emblema e Republikës së Kosovës, dhe që numri unik i lëndës të vendoset në anën e djathtë të tij etj.

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008, neni 31.

² Ligji Nr. 06/L – 054 për Gjykatat, 2018, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

³ Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2019 për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara, 2019.

GJYKATA SUPREME

Gjykata Supreme, duke përfshirë Kolegjin e Apelit dhe Dhomën e Posaçme, gjatë periudhës janar-dhjetor 2020 ka publikuar gjithsej 1,625 aktgjykime. Ky nivel i publikimit dëshmon rritje të theksuar në krahasim me aktgjykimet e publikuara gjatë periudhës janar-dhjetor 2019, ku Gjykata Supreme gjithsej kishte publikuar 685 aktgjykime.

Në figurën e mëposhtëm është pasqyruar niveli i publikimit të aktgjykimeve nga Gjykata Supreme gjatë periudhës janar – dhjetor 2020.




Figura 1. Niveli i publikimit të aktgjykimeve gjatë periudhës janar-dhjetor 2020 në Gjykatën Supreme.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme gjatë kësaj periudhe ka publikuar 910 aktgjykime, ndërsa Kolegji i Apelit ka publikuar 163 aktgjykime. Publikimi i aktgjykimeve nga Dhoma e Posaçme dhe Kolegji i Apelit për çdo muaj, në mënyrë grafike është paraqitur në figurën e mëposhtme.




Figura 2. Niveli i publikimit të aktgjykimeve nga Dhoma e Posaçme dhe Kolegji i Apelit gjatë periudhës janar-dhjetor 2020.

Pjesa më e madhe e aktgjykimeve të publikuara nga kjo gjykatë janë të natyrës civile, respektivisht 1,246 aktgjykime civile, 240 prej tyre janë të natyrës administrative dhe 136 aktgjykime të natyrës penale, si dhe vetëm 2 aktgjykime për çështje ekonomike.

Në grafikën në vijim është paraqitur ndarja e aktgjykimeve të publikuara nga Gjykata Supreme, sipas llojit të lëndëve.




Tabela 2. Lloji i aktgjykimeve të publikuara nga Gjykata Supreme gjatë periudhës janar-dhjetor 2020.

Nga numri i përgjithshëm i aktgjykimeve të publikuara, gjatë kësaj periudhe të monitorimit, Gjykata Supreme ka publikuar vetëm 2 aktgjykime të natyrës së korrupsionit, 3 aktgjykime të dhunës me bazë gjinore dhe 3 aktgjykime të krimit të organizuar.

Ndërsa sa i përket gjuhës në të cilën janë publikuar, 118 aktgjykime apo 7% prej tyre janë publikuar në gjuhën serbe, ndërsa pjesa tjetër prej 1,507 aktgjykimesh apo 93 % janë publikuar në gjuhën shqipe.

Rregullat që kërkohen nga Vendimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve nga kjo gjykatë nuk janë zbatuar në nivel të kënaqshëm. Nga numri i përgjithshëm i aktgjykimeve të publikuara, vetëm në 149 aktgjykime është zbatuar ky vendim, ndërsa në pjesën tjetër prej 1,527 aktgjykimesh janë evidentuar lëshime në zbatimin e tij.

Në tabelën e mëposhtme është shprehur në mënyrë grafike zbatimi i Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve në aktgjykimet e publikara nga Gjykata Supreme.

NIVELI I ZBATIMIT TË VENDIMIT PËR STANDARDIZIMIN E FORMAVE TË AKTGJYKIMEVE




Figura 3. Përdorimi i Shabllonit për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve në aktgjykimet e publikuara nga Gjykata Supreme gjatë periudhës janar-dhjetor 2020.

Ndërkaq, Udhëzimi Administrativ për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara është zbatuar në përpikmëri në të gjitha aktgjykimet e publikuara nga kjo gjykatë. Pra ndryshe nga periodha janar-dhjetor 2019, ku kemi hasur në 17 aktgjykime të paanonimizuar, tashmë asnjë aktgjykim i kësaj gjykate nuk është publikuar pa fshehjen e të dhënave personale në tërësi.

Nga monitorimi i publikimit të aktgjykimeve të Gjykatës Supreme është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 70 ditë për ti publikuar aktgjykimet. Kjo nënkupton se kjo gjykatë e kalon në mënyrë të ndjeshme afatin e përcaktuar në nenin 6 të Ligjit për Gjykatat, ku kërkohet që aktgjykimet të publikohen në afatin prej 60 ditësh për publikimin e tyre, llogaritur nga dita e shpalljes së aktgjykimeve.

Lëvizja FOL, gjithashtu ka monitoruar se cilët gjyqtarë kanë publikuar më shumë aktgjykime gjatë periudhës janar-dhjetor 2020. Nga ky monitorim kemi listuar nga 5 gjyqtarë të secilës gjykatë që kanë prirë me publikim të aktgjykimeve.

Në figurën e mëposhtme është paraqitur lista prej 5 gjyqtarëve që kanë publikuar më shumë aktgjykime në Gjykatën Supreme gjatë periudhës janar-dhjetor 2020.




Figura 4. Gjyqtarët me më së shumti aktgjykime të publikuara nga Gjykata Supreme gjatë periudhës janar-dhjetor 2020.

GJYKATA E APELIT

Gjykata e Apelit, duke përfshirë Divizionin e Apelit të Mitrovicës, gjatë periudhës janar - dhjetor 2020 ka publikuar gjithsej 1,732 aktgjykime, apo 3 aktgjykime më pak sesa gjatë periudhës janar-dhjetor 2019. Me këtë nivel të publikimit të aktgjykimeve, gjatë kësaj periudhe të monitorimit kjo gjykatë renditet në vendin e shtatë.

Në figurën e mëposhtëm është paraqitur niveli i publikimit të aktgjykimeve nga Gjykata e Apelit gjatë periudhës janar – dhjetor 2020.




Figura 5. Niveli i publikimit të aktgjykimeve gjatë periudhës janar-dhjetor 2020 në Gjykatën e Apelit.

Publikimi i aktgjykimeve në Divizionin e Apelit të Mitrovicës ka vazhduar të jetë i paktë në numër edhe gjatë vitit 2020. Gjatë kësaj periudhe, Divizioni i Apelit të Mitrovicës ka publikuar vetëm 12 aktgjykime.

Në figurën e mëposhtme është paraqitur publikimi i aktgjykimeve në baza mujore nga Divizioni i Apelit të Mitrovicës.



Figura 6. Niveli i publikimit të aktgjykimeve nga Divizioni i Apelit të Mitrovicës gjatë periudhës janar-dhjetor 2020.

Sa i përket natyrës së lëndëve, edhe Gjykata e Apelit ka publikuar më shumë aktgjykime të natyrës civile. Nga totali i përgjithshëm i aktgjykimeve të publikuara, 1,217 prej tyre janë të natyrës civile, 322 sosh të natyrës penale, 149 të natyrës administrative, ndërsa vetëm 43 aktgjykime për çështje ekonomike.

Në tabelën e mëposhtme është përshkruar publikimi i aktgjykimeve të Gjykatës së Apelit, të ndarë sipas llojit të lëndëve.




Tabela 3. Lloji i aktgjykimeve të publikuara nga Gjykata e Apelit gjatë periudhës janar-dhjetor 2020.

Sa i përket natyrës së aktgjykimeve të publikuar, Gjykata e Apelit gjatë kësaj periudhe ka publikuar 6 aktgjykime të natyrës së korrupsionit, 3 aktgjykime të krimit të organizuar dhe 3 aktgjykime të dhunës me bazë gjinore. Pra publikimi i aktgjykimeve të këtyre natyrave vazhdon të jetë i ulët në Gjykatën e Apelit.

Ndërsa sa i përket gjuhës në të cilën janë publikuar aktgjykimet, Gjykata e Apelit ka publikuar 99 aktgjykime në gjuhën serbe apo 6%, ndërsa pjesa tjetër prej 1,633 aktgjykimesh janë publikuar në gjuhën shqipe.

Zbatimi i Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve nga kjo gjykatë është arritur në nivel të kënaqshëm. Në pjesën prej 1,259 aktgjykimesh vendimi është zbatuar në përpikmëri, ndërsa në 473 aktgjykime ky vendim nuk është zbatuar në mënyrën e përcaktuar në këtë vendim.

Në figurën në vijim është paraqitur niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve në aktgjykimet e publikara nga Gjykata e Apelit.

NIVELI I ZBATIMIT TË VENDIMIT PËR STANDARDIZIMIN E FORMAVE TË AKTGJYKIMEVE




Figura 7. Niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve në aktgjykimet e Gjykatës së Apelit.

Udhëzimi Administrativ për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara është zbatuar në mënyrë të plotë nga të gjitha aktgjykimet e Gjykatës së Apelit të publikuara gjatë kësaj periudhe. Nga numri total i aktgjykimeve të publikuara, respektivisht nga 1,732 aktgjykime, asnjë prej tyre nuk është publikuar pa u anonimizuar. Kjo dëshmon përgjegjësinë dhe përkushtimin e madh të bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të kësaj gjykate, që merren me publikimin e aktgjykimeve.

Nga monitorimi i publikimit të aktgjykimeve të Gjykatës së Apelit është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 52 ditë për ti publikuar aktgjykimet. Kjo nënkupton se kjo gjykatë aktgjykimet i publikon në pajtim me kohën e paraparë për publikimin e tyre në Ligjin për Gjykatat.

Gjyqtarët me më së shumti aktgjykime të publikuara nga Gjykata e Apelit gjatë kësaj periudhe, janë paraqitur në figurën e mëposhtme.




Figura 8. Gjyqtarët me më së shumti aktgjykime të publikuara në Gjykatën e Apelit gjatë periudhës janar-dhjetor 2020

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS

Gjykata Themelore e Prishtinës, duke përfshirë 4 degët e saj (Dega në Podujevë, Dega në Graçanicë, Dega në Lipjan dhe Dega në Glogoc) është gjykata me më së shumti aktgjykime të publikuara gjatë periudhës janar – dhjetor 2020. Gjatë kësaj periudhe kjo gjykatë ka publikuar 4,534 aktgjykime, numër ky që është katërfishuar në krahasim me vitin paraprak (janar-dhjetor 2019), ku kjo gjykatë kishte publikuar 1,912 aktgjykime. Pra statistikat tregojnë për rrijten e transparencës dhe vetëdijësimin e zyrtarëve të kësaj gjykate lidhur me rëndësinë e publikimit të aktgjykimeve.

Dihet se Gjykata Themelore në Prishtinë përbëhet edhe nga tri departamente shtesë (Departamenti Special, Departamenti për Çështje Administrative dhe Departamenti për Çështje Ekonomike), të cilat kanë kompetencë territoriale në tërë territorin e Republikës së Kosovës, prandaj është i kuptueshëm fluksi i madh i lëndëve të kësaj gjykate, në krahasim me gjykatat tjera.

Në grafikën në vijim janë paraqitur të dhënat mbi numrin e aktgjykimeve të publikuara nga Gjykata Themelore e Prishtinës gjatë periudhës janar – dhjetor 2020.

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS




Figura 9. Niveli i publikimit të aktgjykimeve në Gjykatën Themelore të Prishtinës gjatë periudhës janar-dhjetor 2020.

Në këtë numër të madh të publikimit, në masë të madhe kanë kontribuar edhe degët e kësaj gjykate. Dega e Podujevës gjatë kësaj periudhe ka publikuar 572 aktgjykime, Dega e Lipjanit 472 aktgjykime, Dega e Glllogocit 299 aktgjykime dhe Dega e Graçanicës 87 aktgjykime. Shifrat e publikimit të degëve të Gjykatës Themelore në Prishtinë në mënyrë grafike janë paraqitur edhe në figurën në vijim.




Figura 10. Niveli i publikimit të aktgjykimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Prishtinës gjatë periudhës janar-dhjetor 2020.

Ndërkaq sa i përket natyrës së aktgjykimeve të publikuara, ndryshe nga Gjykata Supreme dhe ajo e Apelit, kjo gjykatë prinë me publikimin e aktgjykimeve të natyrës penale. Respektivisht, nga numri i përgjithshëm i publikimit, 2,564 aktgjykime janë të natyrës penale, 989 të natyrës civile, 672 prej tyre administrative dhe 134 aktgjykime për çështje ekonomike.

Ky klasifikim i aktgjykimeve të publikuara nga Gjykata Themelore e Prishtinës është pasqyruar edhe në grafikën e mëposhtme.




Tabela 4. Ndarja e aktgjykimeve të publikuara gjatë periudhës janar-dhjetor 2020 nga Gjykata Themelore e Prishtinës.

Nga aktgjykimet penale, 27 aktgjykime janë për veprat penale të keqpërdorimit të pozitës dhe autoritetit zyrtar, 163 aktgjykime të dhunës me bazë gjinore dhe 29 aktgjykime të krimit të organizuar.

Gjykata Themelore në Prishtinë gjatë periudhës monitoruese ka publikuar 25 aktgjykime në gjuhën serbe apo 0.56 %, ndërsa pjesa tjetër e aktgjykimeve janë publikuar në gjuhën shqipe.

Vendimi për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve është zbatuar në masë të konsiderueshme nga kjo gjykatë. Nga numri i përgjithshëm i aktgjykimeve të publikuara, ky vendim është zbatuar në 4,458 aktgjykime, ndërsa në 76 aktgjykimet tjera janë vërejtur lëshime në zbatimin e tij. Në tabelën e mëposhtme është paraqitur në mënyrë grafike zbatimi i këtij vendimi në aktgjykimet e publikuara të kësaj gjykate.

NIVELI I ZBATIMIT TË VENDIMIT PËR STANDARDIZIMIN E FORMAVE TË AKTGJYKIMEVE




Figura 12. Niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve nga Gjykata Themelore e Prishtinës gjatë periudhës janar-dhjetor 2020.

Ndërkaq sa i përket fshehjes së të dhënave personale në aktgjykimet e publikuara, duhet të theksohet se kjo gjykatë ka treguar kujdes të veçantë. Nga numri i përgjithshëm i aktgjykimeve të publikuara, vetëm 3 aktgjykime janë publikuar të paanonimizuara.

Nga monitorimi i publikimit të aktgjykimeve të Gjykatës Themelore në Prishtinë është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 55 ditë për ti publikuar aktgjykimet. Kjo nënkupton se edhe Gjykata Themelore e Prishtinës aktgjykimet i publikon në kohën e paraparë në Ligjin për Gjykatat.

Gjyqtarët që kanë publikuar më së shumti aktgjykime në Gjykatën Themelore në Prishtinë gjatë periudhës janar-dhjetor 2020 janë paraqitur në grafikonin në vijim.




Figura 13. Gjyqtarët me më së shumti aktgjykime të publikuara në Gjykatën Themelore të Prishtinës gjatë periudhës janar-dhjetor 2020.

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS

Gjykata Themelore e Mitrovicës, duke përfshirë katër degët e saj (Skenderajin, Vushtrrinë, Leposaviqin dhe Zubin Potokun) gjatë periudhës janar - dhjetor 2020 në ueb-faqe kanë publikuar gjithsej 1,910 aktgjykime. Me këto statistika, kjo gjykatë hyn në radhën e katër gjykatave me më së shumti aktgjykime të publikuara gjatë kësaj periudhe.

Publikimi i aktgjykimeve nga Gjykata Themelore e Mitrovicës për secilin muaj, në mënyrë grafike është shfaqur në figurën e mëposhtme.

GJYKATAT THEMELORE E MITROVICËS




Figura 18. Niveli i publikimit të aktgjyimeve nga Gjykata Themelore e Mitrovicës gjatë periudhës janar-dhjetor 2020.

Duhet të theksohet se disa prej degëve të Gjykatës Themelore në Mitrovicë gjatë kësaj periudhe nuk kanë publikuar asnjë aktgjykim për disa muaj me radhë. Fjala është për Degën në Zubin Potok dhe atë në Leposaviq të cilat për 5 muaj nuk kanë publikuar asnjë aktgjykim.

Ndërsa në anën tjetër, Dega në Vushtrri nuk kishte publikuar asnjë aktgjykim gjatë vitit paraprak (2019), ndërsa gjatë periudhës janar-dhjetor 2020 ka publikuar 390 aktgjyime.

Publikimi i aktgjyimeve nga degët e Gjykatës Themelore në Mitrovicë është shfaqur grafiksht në tabelën e mëposhtme.




Figura 19. Niveli i publikimit të aktgjyimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Mitrovicës gjatë periudhës janar-dhjetor 2020.

Pjesa më e madhe e aktgjykimeve të publikuara janë të natyrës penale, përkatësisht 1,322 aktgjykime penale, ndërsa 588 aktgjykime janë të natyrës civile. Në grafikën në vijim është paraqitur ndarja e aktgjykimeve të publikuara nga Gjykata Themelore e Mitrovicës gjatë periudhës janar-dhjetor 2020.



Tabela 6: Ndarja e aktgjykimeve të publikuara nga Gjykata Themelore e Mitrovicës gjatë periudhës janar-dhjetor 2020 sipas llojit të tyre.

Nga aktgjykimet penale, kjo gjykatë gjatë kësaj periudhë ka publikuar 7 aktgjykime të korrupsionit, 26 dhunë në bazë gjinore, si dhe 3 të krimit të organizuar.

Për dallim nga gjykatat e tjera, publikimi i aktgjykimeve në gjuhën serbe në Gjykatën Themelore në Mitrovicë është më i madh se në gjykatat tjera. Nga 1,910 aktgjykime të publikuara në tërësi nga kjo gjykatë, 688 apo 36% të tyre janë në gjuhën serbe, ndërsa 1,222 aktgjykimet tjera apo 64% janë publikuar në gjuhën shqipe.

Duhet të theksohet se Gjykata Themelore e Mitrovicës nuk ka arritur të respektoj mjaftueshëm vendimin e Këshillit Gjyqësorë të Kosovës në lidhje me fshehjen e të dhënave personale, duke publikuar 277 aktgjykime pa fshehjen e këtyre të dhënave. Në disa prej këtyre aktgjykimeve, edhe pse janë fshehur të dhënat personale, ato kanë qenë lehtë të identifikueshme, prandaj edhe janë rradhitur në kuadër të aktgjykimeve të paanonimizuara.

Sa i përket zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve, nga të gjitha aktgjykimet e publikuara nga kjo gjykatë dhe degët e saj, lëshime janë gjetur në 342 aktgjykime. Ndërsa në pjesën tjetër prej 1,845 aktgjykimesh, ky vendim është zbatuar me korrektësi.

Në tabelën e mëposhtme, në mënyrë grafike është shfaqur niveli i zbatimit të këtij vendimi nga Gjykata Themelore e Mitrovicës për secilin muaj.

NIVELI I ZBATIMIT TË VENDIMIT PËR STANDADIZIMIN E FORMAVE TË AKTGJYKIMEVE




Figura 20. Niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve në aktgjykimet e publikuara nga Gjykata Themelore e Mitrovicës.

Nga monitorimi i publikimit të aktgjykimeve të Gjykatës Themelore të Mitrovicës është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 60 ditë për ti publikuar aktgjykimet. Kjo nënkupton se kjo gjykatë sa i përket kohës së publikimit të aktgjykimeve e respekton plotësisht kohën e paraparë në Ligjin për Gjykatat për publikimin e tyre. 1

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur pesë gjyqtarët me më së shumti aktgjykime të publikuara gjatë kësaj periudhe në Gjykatën Themelore të Mitrovicës.




Figura 21. Gjyqtarët që kanë publikuar më së shumti aktgjykime në Gjykatën Themelore të Mitrovicës gjatë periudhës janar-dhjetor 2020.

GJYKATA THEMELORE E PEJËS

Gjykata Themelore e Pejës, duke përfshirë tri degët e saj (Deçanin, Istogun dhe Klinën) gjatë periudhës janar-dhjetor 2020 kanë publikuar 1,390 aktgjykime. Megjithëse qëndron e parafundit sa i përket publikimit të aktgjykimeve, kjo gjykatë ka shënuar rritje të theksuar të publikimit krahasuar me vitin 2019, kur kjo gjykatë kishte publikuar 699 aktgjykime.

Publikimi i aktgjykimeve nga kjo gjykatë gjatë periudhës janar-dhjetor 2020 është pasqyruar në mënyrë grafike në tabelën e mëposhtme.

GJYKATAT THEMELORE E PEJËS




Figura 9. Niveli i publikimit të aktgjykimeve në Gjykatën Themelore të Prishtinës gjatë periudhës janar-dhjetor 2020.

Në këtë numër të madh të publikimit, në masë të madhe kanë kontribuar edhe degët e kësaj gjykate. Dega e Podujevës gjatë kësaj periudhe ka publikuar 572 aktgjykime, Dega e Lipjanit 472 aktgjykime, Dega e Glogocit 299 aktgjykime dhe Dega e Graçanicës 87 aktgjykime. Shifrat e publikimit të degëve të Gjykatës Themelore në Prishtinë në mënyrë grafike janë paraqitur edhe në figurën në vijim.




Figura 31. Niveli i publikimit të aktgjykimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Pejës gjatë periudhës janar-dhjetor 2020.

Nga numri i përgjithshëm i aktgjykimeve të publikuara, 985 aktgjykime janë të natyrës penale, ndërsa 405 sosh janë të natyrës civile. Klasifikimi i aktgjykimeve të publikuara nga kjo gjykatë është përshkruar edhe në grafikën e mëposhtme.




Tabela 9. Lloji i aktgjykimeve të publikuara gjatë kësaj periudhe nga Gjykata Themelore të Pejës.

Nga të gjitha aktgjykimet e publikuara, ne kemi evidentuar vetëm 3 aktgjykime të korrupsionit, 43 aktgjykime të dhunës me bazë gjinore, si dhe 2 aktgjykime të krimit të organizuar.

Gjykata Themelore e Pejës gjatë kësaj periudhe, njejtë sikurse në vitin paraprak, nuk kishte publikuar asnjë aktgjykim në gjuhën serbe.

Sa i përket fshehjes së të dhënave personale edhe kjo gjykatë ka treguar kujdes të veçantë. Gjatë monitorimit, nga numri i përgjithshëm i aktgjykimeve të publikuara nga kjo gjykatë, ne kemi evidentuar 7 aktgjykime të paanimizuara.

Zbatimi i Vendimit të KGJK-së për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve është arritur në shumicën e aktgjykimeve të publikuara nga kjo gjykatë. Lëshime në zbatimin e këtij vendimi janë gjetur në 103 aktgjykime të publikuara. Në tabelën e mëposhtme është shfaqur niveli i zbatimit të këtij vendimi nga kjo gjykatë gjatë kësaj periudhe.

NIVELI I ZBATIMIT TË VENDIMIT PËR STANDARDIZIMIN E FORMAVE TË AKTGJYKIMEVE




Figura 32. Niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve në aktgjykimet e publikuara nga Gjykata Themelore e Pejës.

Nga monitorimi i publikimit të aktgjykimeve të Gjykatës Themelore të Pejës është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 112 ditë për ti publikuar aktgjykimet. Kjo nënkupton se kjo gjykatë e kalon dukshëm kohën e paraparë në Ligjin për Gjykatat për publikimin e aktgjykimeve.

Në tabelën e mëposhtme janë listuar gjyqtarët me më së shumti aktgjykime të publikuara gjatë periudhës janar-dhjetor 2020 nga Gjykata Themelore e Pejës.




Figura 33. Gjyqtarët me më së shumti aktgjykime të publikuara gjatë periudhës janar-dhjetor 2020 në Gjykatën Themelore të Pejës.

GJYKATA THEMELORE E PRIZRENIT

Gjykata Themelore e Prizrenit, duke përfshirë Degën e Suharekës dhe atë të Dragashit, është vlerësuar si gjykata e dytë me më së shumti aktgjykime të publikuara gjatë kësaj periudhe të monitorimit. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2020 kjo gjykatë ka publikuar gjithsej 2,738 aktgjykime, apo dyfish më shumë aktgjykime se sa gjatë vitit 2019 (1,908 aktgjykime).

Në tabelën në vijim, në mënyrë grafike është pasqyruar shkalla e publikimit të aktgjykimeve nga kjo gjykatë gjatë kësaj periudhe.

GJYKATAT THEMELORE E PRIZRENIT




Figura 22. Niveli i publikimit të aktgjykimeve të Gjykatës Themelore të Prizrenit gjatë periudhës janar-dhjetor 2020.

Kontribut të madh në rritjen e publikimit të aktgjykimeve në kuadër të kësaj gjykate kanë pasur edhe dy degët e saj. Duhet të theksohet se Dega e Suharekës është dega me më së shumti aktgjykime të publikuara, respektivisht me 857 aktgjykime të publikuara gjatë kësaj periudhe të monitorimit. Ndërsa Dega e Dragashit në ueb- faqe ka publikuar gjithsej 190 aktgjykime.

Publikimi i aktgjykimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Prizrenit është shfaqur në mënyrë grafike për secilin muaj në tabelën e mëposhtme.




Figura 23. Niveli i publikimit të aktgjykimeve nga Degët e Gjykatës Themelore të Prizrenit gjatë periudhës janar-dhjetor 2020.

Sa i përket natyrës së aktgjykimeve të publikuara, kjo gjykatë prinë me publikimin e aktgjykimeve penale, me 2,136 sosh, ndërsa ka publikuar dyfish më pak aktgjykime civile. Klasifikimi i aktgjykimeve sipas llojit të tyre është përshkruar edhe në tabelën e mëposhtme.




Tabela 7. Ndarja e aktgjykimeve të publikuara nga Gjykata Themelore e Prizrenit gjatë periudhës janar-dhjetor 2020 sipas llojit të lëndës.

Nga aktgjykimet penale të publikuara, vetëm 4 prej tyre kanë të bëjnë me vepra penale të korrupsionit, 46 me dhunë me bazë gjinore dhe 7 aktgjykime me veprat penale të krimit të organizuar.

Sa i përket gjuhës në të cilën janë publikuar aktgjykimet, duhet të theksohet se gjatë kësaj periudhe nuk është publikuar asnjë aktgjykim në gjuhën serbe. Pra të gjitha aktgjykimet e Gjykatës Themelore të Prizrenit gjatë periudhës janar-dhjetor 2020 kanë qenë vetëm në gjuhën shqipe.

Sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale kjo gjykatë ka treguar kujdes të veçantë. Nga të gjitha aktgjykimet e publikuara nga kjo gjykatë, asnjë aktgjykim nuk është evidentuar i paanonimizuar.

Edhe Vendimi i Këshillit Gjyqësorë për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve është zbatuar relativisht shumë në aktgjykimet e publikuara të kësaj gjykate, madje ka pasur rezultat pozitiv në krahasim me vitin paraprak. Nga të gjitha aktgjykimet e publikuara nga kjo gjykatë, lëshime në zbatimin e këtij vendimi janë vërejtur në 318 aktgjykime, apo në 11 % të tyre. Ndërkaq në pjesën tjetër prej 2,420 aktgjykimesh, shablloni është aplikuar në përpikmëri.

Në grafikonin e mëposhtëm është përshkruar niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve në aktgjykimet e Gjykatës Themelore të Prizrenit, për çdo muaj.

NIVELI I ZBATIMIT TË VENDIMIT PËR STANDARDIZIMIN E FORMAVE TË AKTGJYKIMEVE




Figura 24. Niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve në aktgjykimet e publikuara nga Gjykata Themelore e Prizrenit.

Nga monitorimi i publikimit të aktgjykimeve të Gjykatës Themelore të Prizrenit është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 317 ditë për ti publikuar aktgjykimet. Pra kjo gjykatë e kalon në mënyrë të theksuar kohën e paraparë në Ligjin për Gjykatat për publikimin e aktgjykimeve, duke publikuar kështu edhe aktgjykime të vitit 2013.

Pesë gjyqtarët, të cilët kanë publikuar më së shumti aktgjykime në Gjykatë Themelore të Prizrenit janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.




Figura 25. Gjyqtarët me më së shumti aktgjykime të publikuara në Gjykatën Themelore të Prizrenit gjatë periudhës janar-dhjetor 2020.

GJYKATA THEMELORE E FERIZAJT

Gjykata Themelore e Ferizajt, duke përfshirë Degën e Kaçanikut dhe atë të Shtërpcës, gjatë periudhës janar – dhjetor 2020 ka publikuar 1,937 aktgjykime. Publikimi i aktgjykimeve nga kjo gjykatë është rritur dukshëm krahasuar me vitin paraprak (janar-dhjetor 2019), kur kjo gjykatë kishte publikuar 1,542 aktgjykime. Kjo gjykatë renditet e treta sa i përket nivelit të publikimit të aktgjykimeve gjatë kësaj periudhe.

Në figurën e mëposhtme është shfaqur në mënyrë grafike publikimi i aktgjykimeve për çdo muaj nga kjo gjykatë, gjatë periudhës janar-dhjetor 2020.

GJYKATA THEMELORE E FERIZAJT




Figura 14. Niveli i publikimit të aktgjykimeve për çdo muaj nga Gjykata Themelore e Ferizajt gjatë periudhës janar-dhjetor 2020.

Edhe degët e kësaj gjykate kanë publikuar numër relativisht të madh të aktgjykimeve. Dega e Kaçanikut gjatë kësaj periudhe ka publikuar 290 aktgjykime, ndërsa Dega e Shtërpcës ka publikuar 44 aktgjykime.

Në tabelën e më poshtme në mënyrë grafike është shfaqur publikimi i aktgjykimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Ferizajt, për çdo muaj.




Figura 15. Publikimi i aktgjykimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Ferizajt gjatë periudhës janar-dhjetor 2020.

Gjykata Themelore e Ferizajt, sikurse Gjykata Themelore në Prishtinë, gjatë periudhës së monitorimit ka publikuar dukshëm më shumë aktgjykime të natyrës penale, sesa civile. Nga numri i përgjithshëm i aktgjykimeve, 1,401 aktgjykime janë të natyrës penale, ndërsa 536 të natyrës civile. Në tabelën e mëposhtme është shfaqur ndarja e aktgjykimeve të publikuara gjatë kësaj periudhe nga Gjykata Themelore e Ferizajt, sipas llojit të tyre.




Tabela 5. Ndarja e aktgjykimeve të publikuara gjatë periudhës janar-dhjetor 2020 nga Gjykata Themelore e Ferizajt sipas llojit të lëndëve.

Nga të gjitha aktgjykimet penale të publikuara nga kjo gjykatë, 6 prej tyre janë për veprat penale të korrupsionit, 65 aktgjykime të dhunës me bazë gjinore dhe vetëm 7 aktgjykime të krimit të organizuar.

Sa i përket gjuhës në të cilën janë publikuar këto aktgjykime, kjo gjykatë gjatë periudhës janar-dhjetor 2020 ka publikuar 37 aktgjykime në gjuhën serbe apo 2%, ndërsa të tjerat në gjuhën shqipe.

Gjykata Themelore e Ferizajt bashkë me degët e saj është ndër gjykatat që më së shumti e ka zbatuar Vendimin e KGJK-së për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve. Gjatë kësaj periudhe, ky vendim është zbatuar në 1,851 aktgjykime apo 96% nga totali i përgjithshëm, ndërsa në pjesën tjetër prej 86 aktgjykimesh, është vërejtur lëshime në zbatimin e tij.

Në tabelën e mëposhtme mund të shihet zbatimi i Vendimit për Standardizmin e Formave të Aktgjykimeve nga Gjykata Themelore e Ferizajt.

NIVELI I ZBATIMIT TË VENDIMIT PËR STANDARDIZIMIN E FORMAVE TË AKTGJYKIMEVE




Figura 16. Niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve nga Gjykata Themelore e Ferizajt.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2020, Gjykata Themelore e Ferizajt ka ngecur në fshehjen e të dhënave personale në 28 aktgjykime të publikuara, ndërsa aktgjykimet tjera kanë qenë të anonimizuara në tërësi.

Nga monitorimi i publikimit të aktgjykimeve të Gjykatës Themelore të Ferizajt është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 51 ditë për ti publikuar aktgjykimet. Kjo nënkupton se kjo gjykatë aktgjykimet i publikon brenda kohës së paraparë në Ligjin për Gjykatat për publikimin e tyre.

Në tabelën e mëposhtme janë renditur pesë gjyqtarët me më së shumti aktgjykime të publikuara gjatë periudhës janar-dhjetor 2020, nga Gjykata Themelore e Ferizajt.




Figura 17. Gjyqtarët me më së shumti aktgjykime të publikuara nga Gjykata Themelore të Ferizajt gjatë periudhës janar-dhjetor 2020.

GJYKATA THEMELORE E GJILANIT

Gjykata Themelore e Gjilanit, duke përfshirë tri degët e saj (Degën e Kamenicës, Vitisë dhe të Novobërdës) është ndër gjykatat me më së paku aktgjykime të publikuara gjatë kësaj periudhe të monitorimit. Kjo gjykatë ka publikuar gjithsej 1,147 aktgjykime, numër ky që është shumëfishuar në raport me vitin paraprak (2019), kur kjo gjykatë kishte publikuar 298 aktgjykime. Pra sa i përket nivel të publikimit, gjatë periudhës janar-dhjetor 2020 kjo gjykatë renditet si gjykata me më së paku aktgjykime të publikuara për vitin 2020.

Niveli i publikimit të aktgjykimeve nga kjo gjykatë për secilin muaj, është paraqitur në mënyrë grafike në tabelën e mëposhtme.

GJYKATA THEMELORE E GJILANIT




Figura 34. Niveli i publikimit të aktgjykimeve nga Gjykata Themelore e Gjiçanit gjatë periudhës janar-dhjetor 2020.

Duhet të theksohet se degët e Gjykatës Themelore të Gjiçanit kanë filluar të aktivizohen sa i përket publikimit të aktgjykimeve në këtë periudhë të monitorimit. Dega e Vitisë gjatë kësaj periudhe ka publikuar 69 aktgjykime, Dega e Kamenicës 73 aktgjykime, ndërsa Dega e Novobërdës ka publikuar 43 aktgjykime. Niveli i publikimit të aktgjykimeve nga degët e kësaj gjykate për çdo muaj, është shfaqur në mënyrë grafike në tabelën e mëposhtme.




Figura 35. Niveli i publikimit të aktgjykimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Gjiçanit.

Pjesa më e madhe e aktgjykimeve të publikuara nga kjo gjykatë, apo 796 aktgjykime, janë të natyrës penale. Ndërsa pjesa tjetër prej 351 aktgjykimesh janë të natyrës civile. Kjo ndarje e aktgjykimeve të publikuara gjatë kësaj periudhe nga kjo gjykatë mund të shihet edhe në grafikën e mëposhtme.




Tabela 9: Ndarja e aktgjykimeve të publikuara nga Gjykata Themelore e Gjilanit sipas llojit të lëndëve.

Nga të gjitha lëndët e natyrës penale të publikuara në ueb-faqen e KGJK-së, FOL ka evidentuar 14 aktgjykime të korrupsionit, 36 aktgjykime me bazë në dhunë gjinore, si dhe 14 aktgjykime për veprat penale të krimit të organizuar.

Nga të gjitha aktgjykimet e publikuara gjatë kësaj periudhe, vetëm 44 prej tyre janë të publikuara në gjuhën serbe (4%), ndërsa pjesa tjetër në gjuhën shqipe.

Kujdes i theksuar është treguar në fshehjen e të dhënave personale gjatë publikimit të aktgjykimeve nga kjo gjykatë. Ne gjatë monitorimit kemi evidentuar vetëm 3 aktgjykime të paanonimizuar.

Edhe zbatimi i Vendimit për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve nga kjo gjykatë është arritur në nivel të kënaqshëm. Gjatë monitorimit ne kemi evidentuar 83 aktgjykime në të cilat ka pasur lëshime në zbatimin e këtij vendimi. Niveli i zbatimit të këtij vendimi në mënyrë grafike është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

NIVELI I ZBATIMIT TË VENDIMIT PËR STANDARDIZIMIN E FORMAVE TË AKTGJYKIMEVE




Figura 36. Niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve në aktgjykimet e publikuara nga Gjykata Themelore e Gjilanit.

Nga monitorimi i publikimit të aktgjykimeve të Gjykatës Themelore të Gjilanit është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 131 ditë për ti publikuar aktgjykimet. Kjo nënkupton se kjo gjykatë e kalon në mënyrë të theksuar kohën e paraparë në Ligjin për Gjykatat për publikimin e aktgjykimeve.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur gjyqtarët me më së shumti aktgjykime të publikuara nga Gjykata Themelore e Gjilanit, gjatë periudhës janar-dhjetor 2020.




Figura 37. Gjyqtarët me më së shumti aktgjykime të publikuara në Gjykatën Themelore të Gjiçanit gjatë periudhës janar-dhjetor 2020.

GJYKATA THEMELORE E GJAKOVËS

Gjykata Themelore e Gjakovës, duke përfshirë Degën e Rahovecit dhe atë të Malishevës, gjatë kësaj periudhe në ueb-faqen zyrtare ka publikuar gjithsej 1,742 aktgjykime. Ky numër i publikimit gjatë kësaj periudhe është rritur dukshëm në krahasim me vitin paraprak (2019), ku kjo gjykatë kishte publikuar 1,251 aktgjykime. Me këta numra statistikorë, shihet qartë se ka një avancim të dukshëm të publikimit nga kjo gjykatë, edhe përkundër faktit se renditet e gjashta sa i përket nivelit të publikimit të aktgjykimeve në ueb-faqen zyrtare të KGjK-së.

Niveli i publikimit të aktgjykimeve nga Gjykata Themelore e Gjakovës për secilin muaj të kësaj periudhe është shfaqur në mënyrë grafike në tabelën e mëposhtme.

GJYKATA THEMELORE E GJAKOVËS




Figura 26. Niveli i publikimit të aktgjykimeve për çdo muaj nga Gjykata Themelore e Gjakovës, gjatë periudhës janar-dhjetor 2020.

Edhe degët e kësaj gjykate kanë kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në rritjen e publikimit të aktgjykimeve në kuadër të kësaj gjykate. Gjatë kësaj periudhe, Dega e Malishevës ka publikuar 287 aktgjykime, ndërsa Dega e Rahovecit 428 aktgjykime. Në tabelën e mëposhtme në mënyrë grafike është pasqyruar publikimi i aktgjykimeve të degëve të Gjykatës Themelore të Gjakovës gjatë kësaj periudhe.




Figura 27. Niveli i publikimit të aktgjykimeve nga Degët e Gjykatës Themelore të Gjakovës gjatë periudhës janar-dhjetor 2020.

Sa i përket llojit të aktgjykimeve të publikuara, numër shumëfish më i madh i tyre janë të natyrës penale, respektivisht 1,380 aktgjykime të kësaj natyre, ndërsa 362 aktgjykime janë të natyrës civile. Kjo ndarje e aktgjykimeve të publikuara nga Gjykata Themelore e Gjakovës është paraqitur edhe në grafikonin e mëposhtëm.




Tabela 8. Ndarja e aktgjykimeve të publikuar nga Gjykata Themelore e Gjakovës gjatë kësaj periudhe sipas llojit të lëndëve.

Nga aktgjykimet penale, gjatë kësaj periudhe kjo gjykatë ka publikuar 10 aktgjykime të korrupsionit, 37 aktgjykime të dhunës me bazë gjinore dhe 5 aktgjykime të krimit të organizuar.

Sikurse aktgjykimet e Gjykatës Themelore të Prizrenit, edhe në Gjykatën Themelore të Gjakovës të gjitha aktgjykimet janë publikuar në gjuhën shqipe.

Sa i përket anonimizimit të aktgjykimeve nga kjo gjykatë, gjatë kësaj periudhe janë evidentuar 7 aktgjykime të paanonimizuara.

Vendimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve është zbatuar në pjesën më të madhe të aktgjykimeve të publikuara nga kjo gjykatë. Lëshime në zbatimin e këtij vendimi janë evidentuar vetëm në 24 aktgjykime të publikuara. Zbatimi i këtij vendimi nga kjo gjykatë është paraqitur në mënyrë grafike edhe në tabelën e mëposhtme.

NIVELI I ZBATIMIT TË VENDIMIT PËR STANDARDIZIMIN E FORMAVE TË AKTGJYKIMEVE




Figura 28. Niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve në aktgjykimet e publikuara nga Gjykata Themelore e Gjakovës.

Nga monitorimi i publikimit të aktgjykimeve të Gjykatës Themelore të Gjakovës është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 97 ditë për ti publikuar aktgjykimet. Kjo nënkupton se edhe kjo gjykatë e kalon dukshëm kohën e paraparë në Ligjin për Gjykatat për publikimin e aktgjykimeve.

Gjyqtarët me më së shumti aktgjykime të publikuara në Gjykatën Themelore të Gjakovës janë paraqitur në grafikën e mëposhtme.




Figura 29. Gjyqtarët me më së shumti aktgjykime të publikuara në Gjykatën Themelore të Gjakovës gjatë periudhës janar-dhjetor 2020.

REKOMANDIME

Bazuar në të gjeturat e këtij raporti monitorues, rekomandimet në vijim shihen si të domosdoshme për përmirësimin e ngecjeve të evidentuara në këtë fushë. Këto rekomandime janë:

- Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të monitoroj gjykatat mbi nivelin e zbatimit të të gjitha rregulloreve dhe vendimeve të KGJK-së, duke përfshirë edhe Vendimin për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve. Në të njëjtën kohë, KGJK duhet të kërkoj nga kryetarët e gjykatave që të raportojnë mbi arsyet e mos zbatimit të rregulloreve dhe vendimeve në fjalë.
- Të përditësohet ueb-faqja e KGJK-së me lajme dhe njoftime të reja, të rëndësishme për publikun, duke përfshirë këtu edhe raportet statistikore në lidhje me aktgjykimet e publikuara për çdo muaj. Një trend i tillë i publikimit të njoftimeve dhe lajmeve të reja në ueb-faqen e KGJK-së pat filluar, por si e tillë nuk është vazhduar.
- Të shmanget publikimi i aktgjykimeve nga kontestet martesore dhe llojet e tjera të aktgjykimeve që përjashtohen nga publikimi, të parapara në Udhëzimin Administrativ për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara.
- Të rritet numri i zyrtarëve për informim në gjykatat me fluks të madh të lëndëve.
- Ngritja e kapaciteteve për zyrtarët përgjegjës për publikimin e aktgjykimeve duhet të jetë prioritet.
- Të shmanget publikimi i aktvendimeve, apo të krijohet një filter i veçantë në ueb-faqen e KGJK-së për publikimin e tyre.
- Çdo aktgjykim para publikimit duhet të rishikohet nga zyrtarët për informim sa i përket harmonizimit të aktgjykimit me Udhëzimin Administrativ për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara si dhe nëse është arritur mbrojtja e të dhënave personale në tërësi.
- Të rritet publikimi i aktgjykimeve të keqpërdorimit të pozitës dhe autoritetit zyrtar, të krimit të organizuar dhe të dhunës në bazë gjinore, si lëndë të natyrave të veçanta.
- Aktgjykimet të publikohen me kohë në ueb-faqen e KGJK-së, e jo të publikohen tërësisht në ditën e fundit të muajit.

- Të respektohet afati prej 60 ditësh, i paraparë në Ligjin për Gjykatat në lidhje me publikimin e tyre.
- Secila lëndë ta ketë numrin unik të lëndës. Gjatë monitorimit, FOL ka hasur edhe në aktgjykime me numra identik të lëndëve, e të cilat në përmbajtje kanë qenë të ndryshme.
- Të gjitha aktgjykimet të publikohen në formatin PDF, siç kërkohet në Udhëzimin Administrativ për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara.

BURIMET:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Prill, 2008.
- Këshilli i Evropës, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Tetor, 2013.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji (nr. 06/L-054) për Gjykatat, Dhjetor, 2018.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji (nr.04/L-032) për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Gjykatat.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Udhëzimi Administrativ (02/2016) për Anonimizimin dhe Publikimin e Aktgjykimeve të Plotëfuqishme, Shkurt 2016.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Udhëzimi Administrativ (04/2019) për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara, Dhjetor, 2019.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Shabllonet Standarde të Aktgjykimeve – Vëllimi 1, 2018.